

Exhlale DOBRUNA-SALIHU

KULTIVIMI I HARDHISË SË RRUSHIT NË DARDANI GJATË ANTIQUITETIT

Hardhia e rrushit është njëra ndër të mirat më të çmuara të njerëzimit, e cila në religjionet rreth Izraelit të lashtë konsiderohej e shejntë, përkatësisht dru hyjnore, kurse prodhimi i saj, vera, për pije perëndish. Jehonë të largët të këtyre besimeve hasim në Dhjatën e Vjetër¹. Prandaj, për lashtësinë, prejardhjen dhe shtrirjen e hardhisë së kultivuar të rrushit (*Vitis vinifera*) janë marrë shumë studiues². Nga studimet më të reja është konstatuar se, megjithëse gjurmët më të hershme të kësaj kulture dhe prodhimit të verës vijnë nga Haji Firuz Tepea në vargmalin Zagros – i cili i ndan shpatijat e Perzisë nga Mesopotamia – në kohën e neolitit, në mes vitëve 5400 dhe 5000, megjithatë, ky proces duhet të ketë ndodhur njëkohësisht në disa vende, prandaj edhe nuk duhet kërkuar vetëm një burim të saj³.

Si e tillë, ajo, para së gjithash është bimë e djepit të civilizimit të Mesdheut dhe e trevave përreth. Në Egje gjetja më e hershme e hardhisë së kultivuar të rrushit është nga lokaliteti Sitagroi në Trakinë jugore, farërat e së cilës, së bashku me ato të hardhisë së egër (*Vitis silvestris*), u zbuluan në shtresat e neolitit të mesëm, rreth vitit 3500⁴. Po ashtu, edhe në pjesën bregdetare të territorit ilir dhe në ujdhesa kultivimi i hardhisë së rrushit gjithsesi është i hershëm, para ardhjes së grekërve në këto anë⁵. Deri sa për

¹ Khr. J. Chevalier – A. Gheerbrant, *Rječnik simbola (Loza)*, Zagreb 1983, 359.

² Nga literatura e shumë khr. M. Zaninović, “Iliri i vinova loza”, *Godišnjak Centra za balkanološka ispitivanja* ANUBiH 13/11, Sarajevo, 1976, 261 e tutje me literaturën e mëhershme dhe burimet.

³ P. McGovern, *Ancient Wine. The Search for the Origins of Viniculture*, Princeton-Oxford 2003, 148.

⁴ Khr. M. Zaninović, vep. cit., 263, shën. 7.

⁵ M. Zaninović, po aty, 268, 270. Autori, njëherësh, vë në dukje faktin se, gjetjet e kokrrave të karbonizuara të rrushit në vendbanimet e Ripaçit dhe të Donja Dolinës në Bosnje, flasin se banorët e kësaj ane këtë bimë e kanë njohur që në kohën e bronzit apo hekurit. Mirëpo,

këtë pjesë dhe trevat tjera ilire në brendi vreshtaria dhe prodhimi i verës kanë qenë në fokus të studimeve të shumë studiuesve⁶, për trevën e Dardanisë kësaj çështjeje nuk i është dhënë ndonjë rëndësi. Kjo është edhe arsyeja që këtë punim ia kemi kushtuar trajtimit të kësaj kulture për ndriçimin e saj edhe në këtë trevë

Rrugëtimi i kultivimit

Afërsia e Dardanisë me botën egjeane-helene dhe fqinjësia me Trakinë, si dhe afërsia me bregdetin adriatik, e gjithashtu edhe lidhjet me Lidinë në Azi të Vogël, një nga trevat ku mendohet se ajo edhe e ka origjinën⁷, me të cilat që herët ka vënë kontakte nëpërmes luginave të lumenjëve Vardar, Dri dhe Moravë, flasin se edhe dardanët para ardhjes së romakëve në këtë trevë e kanë njohur hardhinë. Prandaj, megjithëse, ashtu si edhe fiset e tjera ilire në brendësi të territorit ilir⁸, me siguri, para së gjithash, ishin konsumues të pijeve alkoolike të cilat i prodhonin vet: pijes me mjaltë – *mulsum* dhe llojin e birrës nga drithi – elbi, meli dhe gruri – *sabaium* (*Amian Marcellinus*, XXVI 8)⁹, lidhjet tregtare me Greqinë dhe gjetjet e amforave dhe të enëve tjera qeramike të verës¹⁰, tregojnë se ata herët duhet ta kenë njohur pijen e Dionisit, e cila gjithsesi më parë është konsumuar nga shtresa e lartë, e pasur e popullsisë (aristokracia fisnore)¹¹.

edhe pse nuk mund të dihet se a e kanë kultivuar këtu, apo ka ardhë diku nga jugu, këto gjetje dëshmojnë se ilirët hardhinë e rrushit e kanë njohur herët.

⁶ Po aty, 261 e tutje; M. Bulat, “Tragovi antičkog vinogradarstva i vinarstva u Slavoniji”, *Osječki zbornik* 26, 2002, 45 e tutje; V. Begović-Dvoržak – I. Schrunck, “Brijuni – primjer uspješnog antičkog gospodarstva”, *Histria Antiqua (HistAnt)* 12, Pula, 2004, 66-67, fig. 2-4; A. Škegro, “Tragovi uzgoja vinove loze i masline u dubljem zaleđu istočnog Jadrana u antic”, *HistAnt* 12, 125 e tutje; V. Vidrih Perko – M. Vomer Gojković, “Pijenje vina i kult boga Libera i nalazi iz Poetovije”, *HistAnt* 13, 2005, 323 e tutje; D. Dzino, “Delmati, vino i formiranje etničkog identiteta u predrimskom Iliriku”, *Vjesnik za arheologiju i historiju dalmatinsku* 99, Split, 2006, 71 e tutje.

⁷ Është e njohur se emri Bakhos është i origjinës lidiane, shih V. Zamarovsky, *Heronjtë e miteve antike*, Prishtinë 1985, 112.

⁸ Khr. M. Zaninović, vep. cit., 269, 270; A. Škegro, vep. cit., 125-132.; V. Vidrih Perko – M. Vomer Gojković, vep. cit., 324.

⁹ Për llojet e pijeve te ilirët khr. M. D. Grmek, “Opojna pića i otrovi antiknih Ilira, ”*Farmaceutski glasnik* 6, Zagreb, 1950, 33.

¹⁰ G. Mikulčić, “Kantarosi i skifosi od grobnicata vo Brazda”, *Macedoniae acta archaeologica* Prilep, Skopje 11 (1987-89), 1990, 93-101, T. 1-5; E. Shukriu, *Dardania paraurbane*, Pejë 1996, 123 e tutje, T. 10, 12-15, 20-22, 29, 33, 34, 36, 40-46, 49, 51 (amforat, kantarët, ojnohot, hidriat).

¹¹ Për konsumimin e verës në këtë kohë nga masat e gjera të popullsisë vështirë është të

Mirëpo, kultivimi masovik dhe ndoshta edhe i mirëfilltë i hardhisë dhe, së bashku me të, edhe i prodhimit të verës ka filluar me bashkangjitjen e kësaj treve Perandorisë Romake. Kësaj, pa dyshim, i kanë kontribuar të ardhurit italik dhe greko-lindor, të cilëve iu është ndarë toka, ku kanë ngritur pronat e tyre, madje disa nga ata edhe te medha (*latifundium/ii*), në të cilat kanë kultivuar edhe hardhinë, duke prodhuar edhe sasi më të mëdha të verës. Në mesin e tyre, në pjesën qendrore dhe jugore të Dardanisë, shquhen familjet senatore romake *Furii*, pronarë të latifondeve në qendrat antike *Ulpiana* e *Scupi* dhe në Prizrenin e sotëm dhe, *Pontii* po ashtu pronarë të latifondeve. Një pjesë u takonte edhe fileve romake, nga të cilat shquhen *Papiria* dhe *Pupinia*¹². Latifondet ishin të pranishme edhe në afërsi të *Naissus*-it antik, për çka flasin pronat e mëdha fshatare (*villae rusticae*)¹³.

Përveç tyre në këtë veprimtari kanë kontribuar edhe ushtarët e pensionuar (veteranët), të cilët në agerin e Skupit dhe të Naisit vendosën që në shekullin I, duke poseduar edhe latifonde¹⁴. Mirëpo, gjithsesi duhet pasur parasysh se me vreshtari është marrë edhe popullsia vendase, sidomos në rajonet e sotme të trevave të gjera të Prizrenit (Rahovec-Suharekë), të Gjakovës, të Prokuples, të Leskovcit dhe të Kumanovës, të cilat kanë mbetur deri në ditët e sodit rajone vreshtarie, ku hardhia e rrushit edhe sot luan rol me rëndësi në ekonomi, e në disa nga ato edhe rolin më të rëndësishëm, duke përbërë edhe vende me rëndësi të prodhimit të verës. Në të vërtetë e gjithë Dardania, me tokën pjellore që kishte, që edhe ka qenë faktor i rëndësishëm për penetrimin romak në këtë trevë¹⁵, pa dyshim, krahas drithit në rafshina, ka qenë e përshtatshme edhe për kultivim të hardhisë në shpatija.

thuhet diçka e saktë për arsye se, pos që ishte e shtrenjtë, duhet pasur parasysh edhe faktorin tjetër të rëndësishëm; Dardania, edhe pse ishte e përfshirë në rrjedhat e përgjithshme të botës helene, e ka pasur të theksuar shumë identitetin etnik, prandaj nuk mund të themi asgjë të prerë lidhur me këtë çështje.

¹² A. v. Premmerstein – N. Vulić, *Antike Denkmäler in Serbien und Macedonien, Jahreshefte des Österreichischen Archäologischen Instituts*, 6, Wien, 1903, 26-29; E. Čerškov, *Rimljani na Kosovu i Metohiji*, Beograd 1969, 53, 60.

¹³ P. Petrović, *Niš u antičko doba*, Niš 1976, 59-66, 124.

¹⁴ A. Mócsy, *Gesellschaft und Romanisation in der römischen Provinz Moesia Superior*, Budapest 1970, 29, 67 (në agerin e Skupit); P. Petrović, po aty, 24 (në agerin e Naisit), duke theksuar se për praninë e latifondeve të veteranëve shënime të sakta gjejmë në listën e kastelave të Prokopit.

¹⁵ Khr. E. Čerškov, vep. cit., 53.

Monumentet e vreshtarisë

Rëndësinë e madhe të kultivimit të hardhisë në Dardani gjatë kohës romake më së miri e dëshmojnë monumentet e gurit me paraqitjet dhe përkushtimet e tyre. Në njërën anë, këtë posaqërisht e vë në pah vendi i theksuar i saj që zë në monumentet mbivarrore (stela dhe cipusë) gjatë gjithë kësaj kohe. Ajo, këtu, duke dalë nga ena e verës – amfore, kantari, apo krateri në fund të monumentit, në mesin e të gjitha motiveve dekorativo-simbolike paraqet motivin kryesor dhe më të shumtin, që është edhe




Fig. 1



Fig. 2



Fig. 3

Hershëm, krahas importit (amforave, kantarëve, skifosëve, etj), në sasi më të madhe prodhoheshin enët – vazot monokrome dhe të pikturuara – kryesisht kantarët dhe skifosët sipas modeleve atikase, përkatësisht greke²⁰.

Pos motivit të hardhisë, kultivimi i kësaj kulture është dëshmuar edhe me paraqitje relivore të thikës (drapëzit) të vreshtarisë (*instrumenta vineatica*) në dy monumente të agerit të Skupit (fig. 4, 5), ku me siguri ka qenë e lidhur me veprimtarinë e të ndjerit deri sa ishte gjallë²¹. Meqenëse

karakteristika kryesore e monumenteve mbivarrore të kësaj treve¹⁶ (fig. 1, 2). Në të mirë të kësaj flet fakti se këto monumente në agerin e Skupit, ku janë dukshëm më të pakta për shkak të numrit të madh të të ardhurve, të cilët me vete sollën edhe tipin e ri të monumenteve¹⁷, në të shumtën e rasteve hasen mu në ato vende ku në kohën romake gjendeshin fshatrat (*vici*)¹⁸, siç janë ato te Novosella dhe te Brazda

(fig. 3)¹⁹, ku në Antikitetin e

¹⁶ F. Papazoglu, *Srednjobalkanska plemene u predrimsko doba*, Sarajevo 1969, 156-158; E. Dobruna-Saliu, E., *Plastika dekorative dhe figurative e gurit në Dardani gjatë kohës romake* 1-2, Prishtinë 2003-2005, 126 e tutje.

¹⁷ Për popullsinë e ardhur, e cila sidomos ishte e numërt nga Lindja, khr. B. Dragojević-Josifovska, Scupi et la région de Kumanovo, *Inscriptions de la Mésie Supérieure (IMS)* VI, ed. by F. Papazoglou, Beograd 1982, 32-37.

¹⁸ Po aty, 29-30.

¹⁹ N. Vulić, Antički spomenici naše zemlje, *Spomenik Srpske kraljevske akademije (SKA)* LXXI (55), Beograd, 1931, 215, n. 573 (nga Novo Sela); E. Dobruna-Saliu, vep. cit., 644, n. 29, T. 15, fig. 25, 712, n. 137, T. 70, fig. 129 (nga Novo Sela dhe Brazda).

²⁰ G. Mikulčić, vep. cit.

²¹ B. Dragojević-Josifovska, po aty, 116, n. 110 (nga Skupi); D. Koračević, "Nadgrobnna ploča posvećena veteranu legije VII Claudia", *Živa antika*, XXXIII/2, Skoplje-Skopje, 1983, 215-218, fig. 1-2 (nga Bardovci); interpretimi E. Dobruna-Saliu, "Prikaz ženskog pribora i oruđa na nadgrobnim spomenicima rimskog doba u Dardaniji", *HistAnt* 14, 2006, 57-58, fig. 8, 11.

njëri monument i takon veteranit, mund të paramendohet se ka poseduar pronë në të cilën është marrë me vreshtari.

Sa i takon konsumimit të verës, kjo në mënyrë të veçantë është paraqitur në dy monumente. Te njëri, të gjetur në Kamenicë (Dardanë), në trajtë të pllakës me paraqitje të ritualit mortor, në pjesën e poshtme gjendet figura e mashkullit i cili pi lëng me riton nga ena e madhe (kantari i stilizuar), pa dyshim verë, që ka të bëjë me paraqitjen simbolike të “gostisë” për nder të të vdekurit (fig. 6)²². Te monumenti tjetër fjala është për një stelë nga *Timacum minusi* (Ravna), te e cila në xokol, në mes të kërcejve të



Fig. 4



Fig. 5

hardhisë me vile rrushi dhe gjethe që del nga amfora, është paraqitur gota (fig. 7)²³.

²² E. Dobruna-Saliu, “Newly discovered funerary monument in Kosova presenting the funeral ritual among the Dardanians in the Roman period”, *Illyrica antiqua*. Ob honorem Duje Rendić-Miočević, International conference on issues in Ancient Archaeology (Zagreb, 6-8 Novembre 2003), Zagreb, 2005, 199 e tutje, fig. 2.

²³ Khr. P. Petrović, *Timacum minus et la vallée du Timoc*, *IMS III/2*, Beograd 1995, 117-118, n. 81



Fig. 6




Fig. 7

Në anën tjetër, për kultivimin e hardhisë dokument bindës paraqesin monumentet e kultit – ikonografike dhe epigrafike – të përkushtuara Dionist – Liberit, meqë nderimi i kultit të kësaj perëndie, i cili në trevën e Dardanisë paraqet një perëndi të vjetër vendase me veti të ngjashme, lidhet ngushtë edhe me kultivimin e hardhisë edhe mjeshttrinë e prodhimit të verës²⁴.

Monumentet ikonografike janë të pranishme me ato të punuara në relief dhe në skulpturë të plotë. Relievat vijnë nga dy lokalitete, ku i takojnë gjysmës së dytë të shekullit II dhe fillimit të shekullit III. Njëri është gjetur në Vrellë të Istogut afër Pejës, në arealin e municipit me emër të panjohur në rrjedhën e epërme të Drinit të Bardhë. Te ky ekzemplar në gjithë sipërfaqen është skalitur Dionisi-Liberi nudo – vetëm me *nebrys* dhe qizme të thella – me shoqëruesit e tij (*thiasos*): satirin, silenin, i cili mban një gjë të paqartë, dhe Panin (Silvanin) e ulur në një shkëmb duke i ra *syrinx*-it. Në anën e majtë dhe sipër pllaka kufizohet me një degë të hollë hardhie me një vile rrushi dhe një kantar në bazament (fig. 8)²⁵. Ekzemplari (pllaka) tjetër

²⁴ M. A. Bruhl, *Liber Pater. Origine et expansion du culte dionysiaque a Rome et dans monde Romain*, Paris 1953.

²⁵ E. Dobruna-Saliu, “Nderimi i perëndive të plleshmërisë dhe vegetacionit në Dardani”, *Saxa loquuntur*, Prishtinë 2016, 405-408., fig. 1



Fig. 8




Fig. 9

vjen nga Barova në agerin e Skupit, ku janë skalitur së bashku Liberi dhe Libera (Dionisi dhe Ariadna). Edhe në këtë rast perëndia është paraqitur vetëm me *nebrys* dhe qizme të thella, i cili me njërën dorë përkdhel Ariadnën, e cila mban një vile rrushi (fig. 9)²⁶. Po në këtë vend është gjetur edhe një cipus mbivarraror i qarkuar me motivin e hardhisë (fig. 10)²⁷. Ekzemplarët tjerë janë në skulpturë të plotë (nga shekujt II dhe fillimi shekullit IV), ku, kjo perëndi, gjithashtu është paraqitur me shoqëruesit. Ata janë mjaft të fragmentuar. Njëri është gjetur në vet Skupin, kurse dy të tjerët janë nga *Mediana* (Bërzi Brodi) në agerin e Naisit, ku në njërin ekzemplar në mes të mbështetëses dhe këmbës së perëndisë është skalitur një vile rrushi²⁸. Nga monumentet epigrafike kushtuar Liberit, njëri – një altar nga shekulli III – është nga ageri i Skupit, i gjetur në Luboten²⁹. Kurse dy të

²⁶ N. Vulić, *Spomenik SKA LXXI* (55), 207-208, n. 549; E. Dobruna-Saliu, *Plastika dekorative dhe figurative e gurit...*, 807-808, n. 309, T. 145, fig. 267; e njëjta, “Štovanje Silvana i Dijane, Libera i Libere u Dardaniji”, *HistAnt* 13, 226, fig. 3.

²⁷ N. Vulić, po aty, 207, n. 548; B. Dragojević-Josifovska, vep. cit., 126, n. 127; E. Dobruna-Saliu, *Plastika...*, 788, n. 274, T. 124, fig. 235.

²⁸ Khr. E. Dobruna-Saliu, “Štovanje...”, 227, fig. 4-6.

²⁹ B. Dragojević-Josifovska, po aty, 55-56, n. 11.

tjerët janë nga ageri i Naisit (shekujt II dhe III), të cilët janë mjaft interesant si për nga vendi i gjetjës, ashtu edhe për nga epitetet e kësaj perëndie.

Njëri monument ka të bëjë me pllakën e gjetur në fshatin Pusto Shilovë te Leskovci, të zbuluar në një terren bujqësor jashtë mjedisit të urbanizuar (qytetar), në të cilën përmendet fshati (*vicus*) pa emër të shënuar³⁰. Liberi, këtu, me epitetin e rrallë *laetus* (i gëzueshëm) – krahas atyre të zakonshëm *pater* dhe *sanctus* – që është i pranishëm edhe në relievin e njohur nga *Salona* (Solini) (në provincën e Dalamcisë) me përkushtimin *Deo Laet[o]*³¹, në të gjithë territorin e gjerë ilir ka paraqitur një perëndi epikorike të vegetacionit³². Ai këtu, ashtu si edhe në trevat e tjera ilire dhe, më gjerë, në bazenin danubian, nderohej nga popullsia vendase edhe në bashkësit e tyre fshatare, që i përgjigjet natyrës së tij, meqë në radhë të parë ishte perëndi bujqish³³, të cilët pa dyshim merreshin me vreshtari dhe prodhimin e verës. Monumenti tjetër, ku fjala është për altar, u zbulua në vet Naisin dhe i përkushtohet çiftit Liber dhe Libera; shoqërueses në formën *Hilara* (*Libero et Hilarae*), e cila për herë të parë

paraqitet në një mbishkrim latin³⁴. Identifikimi i Hilarës me Liberën u konstatua nga ana e Th. Mommsenit dhe pas tij edhe nga A. Bruhli, ku epiteti *hilara* (e gëzueshme) asaj i përgjigjet plotësisht³⁵. Të dy epitetet flasin për faktin se ky çift perëndishe, për të cilin Bruhli ka shprehur mendimin se bëhet fjalë për një çift perëndishe




Fig.10

³⁰ P. Petrović, *Niš u antičko doba*, 140; i njëjti, Naissus-Remesiana-Horreum Margi, *IMS* IV, Beograd 1979, 121, n. 105.

³¹ Gabričević, B., "Deus Laetus", *Vjesnik za arheologiju i historiju dalmatinsku*, 56-59/1, 1954.-57., *Antidoron Michaeli Abramić* 1, Split, 1957, 136 e tutje, T. 11.

³² B. Gabričević, po aty, 137; P. Petrović, *Niš ...*, 140.

³³ M. Zaninović, "Štovanje Libera na istočnom Jadranu", Simpozijum "Duhovna kultura Ilira" (Herceg Novi, 4.-6. 11. 1982.), Posebna izdanja *Centra za balkanološka ispitivanja* 67/11, Sarajevo, 1984, 251.

³⁴ P. Petrović, *Niš ...*, 139; i njëjti, Naissus-..., 9, n. 25 (monumenti në të vërtetë u kushtohet Jupiterit e Junonës dhe Liberit e Hilarës).

³⁵ Th. Mommsen, ad *CIL* 3 1680; M. A. Bruhl, vep. cit., 217.

vendëse³⁶, pos perëndive të plleshmërisë dhe vegjetacionit, ishin edhe perëndi të gëzimit, që gjithsesi është e lidhur me pijen e kësaj perëndie – verën dhe kulturën e përjetësimt të saj.

Për kultivimin e hardhisë dhe prodhimin e verës dëshmojnë edhe monumentet tjera arkeologjike. Të një rëndësie të veçantë janë mbeturinat e presave për shtryedhjen e rrushit (*torcularia*), ku kemi të bëjmë me pllaka monolite të gurit (*area*), të cilave iu mungon konstrukcioni i sipërm i drurit. Ato, deri më tash, janë zbuluar në agerin e Naisit dhe vijnë mu nga ato lokalitete ku u zbuluan monumentet votive të Liberit Dy sosh katërkëndëshe u gjetën në fshatin Vërbovc të trevës së Leskovcit³⁷, kurse një me formë rrumbullake në Medianë, e cila u zbulua në perëndim të Muzeut, afër ndërtesës së madhe bujqësore antike (fig. 11)³⁸. Të dy këto trajta të presave hasen edhe në rajonet tjera, si në vendet e ndryshme të sotme të territorit ilir: Brione të Istrës, Muline të ujdhesës Uglan, Mogorjelë te Çaplina, Çerin




Fig. 11

³⁶ M. A. Bruhl, po aty, 156.

³⁷ M. S. Filipović, Arheologija i etnologija, *Leskovački zbornik* 8, 1968, 5-8 me foto.

³⁸ P. Petrović, *Niš...*, 125-126, fig. 50, i cili thekson se afër vilës lukoze suburbane ka pasur më shumë objekte bujqësore.



Fig. 12

Pos këtyre gjetjeve, kultivimi i hardhisë në Dardani është dëshmuar edhe me vegla. Sipas të dhënave të E. Çerškovit, vegla vreshtarie antike kaheër janë gjetur në kompleksin e njohur të vreshtave të lashta mbi Rahovec, por që moti kanë humbur⁴⁴. Kurse sot janë

te Çitluku në Dalmaci, Mirine dhe Leske në Bihovë te Trebinja në Hercegovinë etj.³⁹, ashtu edhe në trevat tjera të Perandorisë, siç është rasti me Mimerkën e siujdhesës Krim në Detin e Zi⁴⁰.

Po ashtu të rëndësishëm janë edhe 15 pitosët e mëdhenj të gjetur në këndin veriperëndimor të ndërtesës bujqësore në Medianë, për të cilët, bazuar në vendin e gjetjes, mund të thuhet se janë përdorur për verë, meqenëse hapsirat (kthinat) për përpunimin dhe ruajtjen e prodhimeve të gatshme – mushtit dhe verës (*cellae vinearia*), gjithmonë gjendeshin në pjesën më të ftoftë, veriperënfimore të ndërtesës⁴¹. Për pitosët tjerë të të njëjtit funksion mund të themi se vijnë nga ato vende të Dardanisë ku edhe sot vreshtaria është kultura kryesore e bujqësisë, si edhe prodhimi e tregtia e verës prioritare⁴². Prodhimin dhe përdorimin e verës në kohën romake e dëshmojnë edhe amforat, por të cilat deri tash janë gjetur në numër të vogël (fig. 12)⁴³.

³⁹ B. Ilakovac, “Rimskodobna proizvodnja vina u Mulinama na otoku Ugljanu”, *Radovi Filozofskog fakulteta u Zadru, Razdio povijesnih znanosti*, Zadar 40 (27), 2003, 49 e tutje, fig. 3-7; A. Škegro, “Tragovi uzgoja vinove loze i masline u dubljem zaleđu istočnog Jadrana u antici”, *HistAnt* 12, 127-128, fig. 2, 4; V. Begović-Dvoržak – I. Schrunk, “Brijuni - primjer uspješnog antičkog gospodarstva”, *HistAnt* 12, 67, fig. 4.

⁴⁰ Khr. B. Ilakovac, po aty, 59-60, fig. 9-10.

⁴¹ M. P. Vitruvius, *Deset knjiga o arhitekturi*, Sarajevo 1990, 131; khr. B. Ilakovac, po aty, 53 e tutje, fig. 3-5, 60-61, i cili thekson se në pjesën verilindore të të ndërtesës tregtare në Mulinë janë gjetur shumë mbeturina të amforave dhe pitosave të thyer.

⁴² Shumica e pitosëve vijnë nga bazeni i Prizrenit, të cilët nuk janë të publikuar. Për një pitos nga Rahoveci që zëntë deri në 400 l. verë (sot gjendet në Teqen Halveti), që herët ka treguar E. Čerškov, “Arheološka zbirka muzeja Kosova i Metohije”, *Glasnik Muzeja Kosova i Metohije*, Pristina 1, 1956, 373.

⁴³ E. Čerškov, *Rimljani na Kosovu i Metohiji*, 71, fig. 19; S. Fidanovski, *Rimska keramika Ulpijane*, Beograd 1990, 53, T. 35.

⁴⁴ E. Čerškov, po aty, 71.

të parnishëm drapëzit (*falces*) e shekullit IV nga Timak minusi dhe Mediana, të gjetur me hulumtime⁴⁵, të cilët shërbenin për krasitje të hardhisë dhe vjelje të rrushit (*falx vinitoria* dhe *falcula vineatica*). Prandaj, gjetjet e këtyre veglave gjithsesi flasin në të mirë të rëndësisë së vreshtarisë në këto lokacione.

Në fund, mund të themi se, edhe pse autorët antikë nuk flasin për hardhinë e rrushit në Dardani, monumentet mbivarrore me paraqitjen e shumtë të këtij motivi dhe ato të kultit kushtuar Dionisit – Liberit së bashku me materialin tjetër arkeologjik ofrojnë mjaft dëshmi mbi kultivimin e saj dhe prodhimin e verës, veprimtaria më intensive e së cilave ka filluar në kohën romake. Shikuar në tërësi, vreshtaria gjatë gjithë kësaj kohe ka paraqitur një rën nga kulturat bujqësore kryesore të kësaj treve, e cila edhe sot e kësaj dite në pjesë të caktuara të saj përbën një rën ndër degët e rëndësishme ekonomike.

⁴⁵ I. Popović, *Antičko oruđe od gvožđa u Srbiji*, Beograd 1988, 78, n. 3, 4, 6-9, 22, 23; 79, n. 4, 8; 80, n. 2, 4.

Exhlale DOBRUNA-SALIHU

SUMMARY

VITICULTURE DURING ANTIQUITY IN DARDANIA

This paper presents a newfound votive monument from the Roman period, dated to the second half of the 2nd or the early 3rd century, found in the central part of Dardania (Kosova). It is a relief made out of local marble of high quality, from the village of Vrelo at Istok near Peja, on the territory of an unknown municipium. It is dedicated to the deity of grape vine and wine (Liber), depicted with his entourage (thiasos) – satyr, Silenus and Pan playing in a scene of merriment over its entire surface. It is the only monument in the whole of Kosovo dedicated to this deity and with this compositional scheme, it is the only example on the whole territory of Dardania, which makes it truly special. Moreover, this depiction on the relief completes in an iconographic sense the epigraphic evidence from the northern part of Dardania mentioning Liber with an epithet »laetus« (merry), thus documenting this deity, under which we understand an old epichoric vegetation deity, having similar characteristics on the entire Dardanian territory.

